



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 35 regjistër (JR)  
Datë 29.06.2021

Nr. 15 i vendimit  
Datë 18.04.2024

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 18.04.2024, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Tasim Puci, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 366, datë 15.04.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Tasim Puci.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr.

49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

### **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet me shkrim, i cili përfundimisht kërkoi konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Në lidhje me rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit Tasim Puci (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje me nenin 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm [me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.09.2018], duke konstatuar se: *1. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin. 2. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë. 3. Ka fshehje pasurie ndër vite. 4. Nuk ka kryer deklaram të rremë. 5. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
4. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, Komisioni zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në tri kriteret: në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës

dhe vlerësimin e aftësisë profesionale. Në përfundim të këtij procesi, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 366, datë 15.04.2021, Komisioni ka konkluduar që subjektit të rivlerësimit Tasim Puci t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, me arsyetimin e përmbledhur në vijim.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Vendimi i Komisionit, për shkarkimin e subjektit nga detyra, është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme:

**5.1. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë:** *“Subjekti i rivlerësimit nuk arriti t'i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi nuk provoi: (i) marrëdhënien e vjehrrit me apartamentin; (ii) burimet e ligjshme financiare të vjehrrit dhe të familjarëve të bashkëshortes për blerjen e këtij apartamenti; dhe (iii) nevojën e vjehrrit për të kryer këtë investim në Tiranë, duke u gjendur në parashikimet e pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në përputhje me pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”.*

**5.2. Për kontrollin e figurës:** *“Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirje e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës”.*

**5.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale:** *“Nga hetimi administrativ i kryer nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon figurën e prokurorit Tasim Puci dhe sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme”.*

## III. Shkaqet e ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit

6. Në datën 03.06.2021, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë ankim brenda afatit ligjor kundër vendimit të Komisionit. Në përfundim të ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji marrjen në shqyrtim të shkaqeve të ankimit dhe: **(i)** gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; **(ii)** konstatimin e shkeljeve të të drejtave Kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja ndaj tij; **(iii)** çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012; **(iv)** ndryshimin e vendimit nr. 366, datë 15.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin e tij në detyrë. Subjekti kërkoi edhe të administrohen 12 akte në cilësinë e provës<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Subjekti paraqiti aktet si vijon së bashku me ankimin: (i) revokim deklarate hartuar përpara noterit në datën 28.04.2021 [me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.]; (ii) dhe (iii) kërkesë të subjektit për informacion dhe kthim përgjigje nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK; (iv) dhe (v) kërkesë për informacion e subjektit të rivlerësimit drejtuar OShEE-së Tiranë, dhe kthim përgjigjeja datë 06.05.2021; (vi) kërkesë për informacion e subjektit të rivlerësimit drejtuar DSIK-së; (vii) kallëzim penal i subjektit të rivlerësimit drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim

6.1. Përpos këtyre kërkimeve, në zbatim të së drejtës që parashikon neni 49 i ligjit nr. 49/2012, për parashtrime me shkrim përpara seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, subjekti ka paraqitur parashtrime dhe akte në Kolegj në datat 05.04.2024 dhe 09.04.2024. Në parashtrimet e datës 09.04.2024 ka bashkëlidhur pasqyrë llogarie në Raiffeisen Bank për vitet 2023 dhe 2024, si dhe fotokopje të faqes së pasaportës së tij e ato të familjarëve, ku është vendosur viza amerikane e datës 09.03.2023.

6.2. Në periudhën e ndërmjetme, e konkretisht mes 16.12.2021 e deri në 26.03.2024, përpos parashtrimeve të datave 5 dhe 9 prill 2024, përpara seancës së caktuar në Kolegj, të përmbledhura më sipër, subjekti ka përcjellë në Kolegj 27 shkresa<sup>2</sup> me parashtrime, informacion dhe një mori aktesh. Ndër këto parashtrime, dy janë nga vjehri i tij<sup>3</sup>, z. G. H., ndërsa 25 të tjerat janë shkresa, kërkesa e parashtrime të subjektit shoqëruar me një mori aktesh (83 të tilla).

6.3. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në shkaqet me natyrë procedurale dhe ato të themelit në kundërshtim të konkluzionin e Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm për pasurinë.

a. *Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale* -- Subjekti i rivlerësimit pretendon se në rivlerësimin e tij nga Komisioni është shkelur parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit, parimi i sigurisë juridike, si dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor nga një vendim i paarsyetuar.

b. *Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë* -- Subjekti ankimon konkluzionin e Komisionit për një automjet, për disa transfertat bankare të kryera nga ai vetë apo personi i lidhur/bashkëshortja dhe i ati, si dhe për apartamentin në Tiranë, e konkretisht:

b.1. *Automjetin [e markës DaimlerChrysler]*, nuk e ka përdorur, pasi banesa e subjektit dhe vendi i punës kanë qenë afër. Konkluzioni i Komisionit se mosregjistrimi i një automjeti është një sjellje e papranueshme për një prokuror, lidhet me shkelje të dispozitave të Kodit Rrugor, të cilat rëndojnë ekonomikisht mbi magjistratin. Në raste të tilla, ligji parashikon sanksione në formën e kamatëvonesave.

b.2. *Transfertat bankare* të kryera ndërmjet subjektit të rivlerësimit, vjehrit të tij dhe bashkëshortes, janë kryer për mobilimin e apartamentit dhe përbëjnë ndihmë të vjehrit ndaj vajzës së tij/bashkëshortes së subjektit. Vjehri ka pasur burime të ardhurat e tij nga puna si elektrikist,

---

të shoqërisë ndërtuese, “{\*\*\*}” ShPK dhe noteres (znj. M. D.) për falsifikim dokumentesh; (viii) kthim përgjigje e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.05.2021; (ix) vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 16.05.2021; (x) ekstrakt i të dhënave nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dega Novara, Itali, me të dhëna për kunatin e subjektit, z. D. H.; (xi) certifikatë vdekje për kunatin e subjektit dhe vjehrrën (përkatësisht z. D. H. dhe znj. S. H.), datë 29.04.2021; si dhe (xii) certifikatë e gjendjes familjare në vitin 2001 të z. G. H..

<sup>2</sup> Konkretisht, subjekti ka kontaktuar e përcjellë në adresë të Kolegjit shkresa në datat: 16.12.2021, 10.01.2022, 24.01.2022, 17.03.2022, 09.03.2022, 10.05.2022, 18.05.2022, 19.05.2022, 05.05.2023, 15.06.2023, 22.05.2023, 07.07.2023, 12.07.2023, 17.07.2023, 26.07.2023, 31.07.2023, 14.08.2023, 23.08.2023, 11.09.2023, 06.10.2023, 08.11.2023, 20.11.2023 dhe 30.12.2023.

<sup>3</sup> Përkatësisht në datat 20.09.2023 dhe 26.03.2024.

depozitat bankare, si dhe dy kredi të marra prej tij për të plotësuar nevojat familjare. Burim krijimi janë edhe të ardhurat nga kunati i tij.

b.3. Hetimi i Komisionit për *apartamentin në Tiranë* bazohet në *raportin e pasaktë e të falsifikuar të ILDKPKI-së* dhe në dokumente të falsifikuara nga shoqëria e ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK. Subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit se nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes në vitin 2004, si dhe pagesën prej 10.000 eurosh, duke qenë se ai nuk ka nënshkruar asnjë kontratë sipërmarrjeje dhe nuk e ka paguar këtë shumë. Sipas tij, e vetmja kontratë sipërmarrjeje për këtë apartament është ajo e datës 25.03.2004, e lidhur ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK dhe vjehrrit të tij, z. G. H..

#### IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

##### A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji

###### i. *Juridiksioni i Kolegjit*

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit nëpërmjet të cilit është kryer rivlerësimi për subjektin Tasim Puci, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Shqyrtimi i vendimeve të Komisionit në Kolegji kryhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### ii. *Legjitimitimi i ankuesit*

8. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

9. Në përputhje me nenin 65, pika 1<sup>4</sup> e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër një vendimi përfundimtar të Komisionit kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi. Pasi analizoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për gjykimin në seancë gjyqësore publike, dhe për të pranuar aktet e sjella prej tij në cilësinë e provave të reja, trupi

---

<sup>4</sup> “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. [...]”.

gjykues i Kolegjit konkludoi të vijoje shqyrtimin e ankimit mbi bazë aktesh, në kushtet që konstatoi se nuk gjen zbatim asnjë nga rrethanat e përcaktuara në ligj<sup>5</sup> për kalimin në seancë gjyqësore publike në praninë e subjektit. Ky vlerësim përfshin analizën e kryer qoftë për shkaqet procedurale apo të vlerësimit të rrethanave faktike përcaktuar nga neni 51 i ligjit nr. 49/2012, në vijim të analizës që shtjellohet më poshtë.

**9.1.** Nga vlerësimi i sipër referuar, trupi gjykues çmon të theksojë që asnjë prej akteve të sjella nga subjekti i rivlerësimit nuk plotëson kriteret e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, për rastet përjashtimore që normon ligji për provat e reja që lejohen me ankimin. Ky konkluzion gjen zbatim qoftë për aktet e sjella me ankimin, parashtrimet përpara seancës në datat 05.04.2024 dhe 09.04.2024, apo në 27 rastet e tjera gjatë të cilave janë dërguar në Kolegj akte e kërkesa të vazhdueshme<sup>6</sup> në periudhën e ndërmjetme mes ankimit dhe caktimit të datës së shqyrtimit të

---

<sup>5</sup> Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[...] 1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. [...]”.

<sup>6</sup> Në periudhën e ndërmjetme mes ankimit dhe parashtrimeve, subjekti ka dërguar në Kolegj aktet e grupuara si vijon: **(i)** gjashtë (6) akte - dokumentacion që lidhet me veprime financiare të kryera nga vjehrra e tij, përfshirë dy mandatarkëtime të datës 13.11.2003, në Bankën Italo-Shqiptare, për vlerat 2.300 USD dhe 1.431.618 lekë, të kaluara në depozita njëvjeçare, vërtetime për tërheqjen e tyre në datat 12.11.2004 dhe 16.11.2004 dhe dy shkresa për gjendjen e tyre në datat 11.11.2003 dhe 16.11.2004; **(ii)** dy certifikata familjare të vjehrrit, datë 15.08.2005, që tregojnë gjendjen familjare të tij në vitin 2009, para dhe pas vdekjes së bashkëshortes; **(iii)** pesë (5) shkresa korrespondence mes ILDKPKI-së, Komisionit dhe subjektit me shoqërinë e ndërtimit, “{\*\*\*}” ShPK, përkatësisht në datat 08.01.2016 26.01.2016 dhe 13.07.2020, si dhe në datat 08.09.2023 dhe 21.09.2023; **(iv)** katër (4) korrespondenca shkresore mes subjektit dhe ILDKPKI-së, përkatësisht në datat 13.01.2022, 28.12.2021, 26.11.2021 dhe 10.12.2021; **(v)** tetë (8) kërkesa të subjektit për informacion dhe përgjigjet, përkatësisht: Ministria e Drejtësisë, datë 11.12.2023, kërkesë noteres M. D., datë 20.09.2023, e datës 28.04.2023 drejtuar OShEE-së dhe Ministres së Energjetikës, e datës 07.11.2023, drejtuar një gjyqtari [z. F. I.], korrespondencë e subjektit e kthim përgjigje nga DSIK-ja, datë 27.05.2021, kërkesë datë 15.03.2022 Ministrisë së Drejtësisë, kthim përgjigje e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, datë 24.03.2023, kthim përgjigje e Raiffeisen Bank, datë 27.08.2021; **(vi)** korrespondencë e vjehrrit të subjektit me pesë (5) institucione të ndryshme (AShK-në, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisaratin e Policisë Nr. 3, Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër) kryer pasi është marrë vendimi objekt ankimi, sikurse edhe një dokument hipotekor datë 21.02.2012 në emër të vjehrrit, si dhe akte që lidhen me punësimin e vjehrrit e vjehrrës së subjektit (tre të tilla); **(vii)** tetë (8) akte që lidhen me procedime penale të iniciuara nga subjekti në ngarkim të individëve të ndryshëm e konkretisht: për shoqërinë ndërtuese, kallëzimi penal i subjektit ndaj OShEE dhe UK Tiranë, datë 13.09.2023, procesverbal mbi kallëzimin e kimit nga subjekti, hartuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, datë 09.12.2021, procesverbal datë 22.07.2021 për të njëjtin kallëzim dhe vendime të gjykatave e prokurorive, konkretisht: datë 12.12.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vendim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për mosfillimin e kallëzimit penal nr. {\*\*\*}, të iniciuar nga subjekti dhe ankimi kundër këtij vendimi dhe dosje të procedimit penal; **(viii)** akte që lidhen me kontestimin e deklaratës noteriale dhe veprimeve të noteres nga subjekti e konkretisht: ankesë kundër noteres M. D., drejtuar Bordit Disiplinor të Noterëve dhe kthim përgjigje datë 14.10.2021, dy kërkesa për informacion, datë 14.10.2021 dhe 26.10.2021, drejtuar kësaj notereje nga Ministria e Drejtësisë, kopje e fletës së regjistrimit noterial manual të noteres dhe faturë tatimore e saj datë 09.12.2021; **(ix)** katër (4) deklaratat noteriale të subjektit e vjehrrit përkatësisht në vitin 2011 dhe tre të tjerat nga disa individë të hartuara pas vendimit të Komisionit më 28.08.2021 dhe gusht e shtator 2023; **(x)** akte që lidhen me pronësinë e apartamentit në Tiranë, e konkretisht: tre kontrata, një mandatarkëtim dhe dokumentacion hipotekor i vitit 2010 dhe akte bashkëlidhur. Ndër kontratat, dy janë porosie, përkatësisht të lidhura në datën 25.03.2004, mes vjehrrit të subjektit dhe shoqërisë ndërtuese (“{\*\*\*}” SHPK), e cila përmban edhe emrin e

ankimit në dhomë këshillimi. Përpos këtyre kërkesave, subjekti ka dërguar edhe parashtrimet përpara seancës në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012. Përveç akteve që gjenden në fashikujt e administruar në Komision gjatë hetimit administrativ, analizuar nën dritën e dispozitave, të cilat normojnë këtë fazë të procesit, referuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se për aktet e tjera subjekti nuk ka provuar pamundësi për paraqitjen e tyre gjatë procesit të hetimit administrativ. Së fundmi, në tërësinë e tyre, vlerësuar edhe nën dritën e përcaktimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, aktet e sjella nga subjekti u gjetën të panevojshme dhe jo përcaktuese për procesin dhe zgjidhjen përfundimtare<sup>7</sup>.

**9.2.** Nga vlerësimi i konkluzioneve të Komisionit dhe pretendimeve në ankimin dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi asnjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, me praninë e subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e tyre. Për këto arsye, trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t'i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar edhe në Kolegj. Po ashtu, edhe kërkimi<sup>8</sup> i subjektit të rivlerësimit, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, nuk rezultoi i bazuar në rastet e parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Kolegji, gjithashtu, vlerësoi kryesisht se: (a) Komisioni ka konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; si dhe (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

**9.3.** Në përmbledhje të arsyetimit dhe analizës së mësipërme, Kolegji e vlerësoi të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

---

*subjektit të rivlerësimit dhe një kontratë sipërmarrje me të njëjtën datë e të njëjtat palë, por pa emrin e subjektit të rivlerësimit, një kontratë noteriale shitjeje, datë 28.12.2011, mes shitësit (“{\*\*\*}” SHPK) dhe vjehrrit të subjektit, në cilësinë e blerësit; (xi) dokumentacion pagesash e konferma bankare, përfshirë fotokopje e një mandatarkëtim, datë 11.11.2002, për shumën 1.200.000 lekë, pasqyrë llogarie bankare, datë 13.02.2018, datë 12.12.2017 dhe datë 14.05.2019, sikurse edhe pasqyrë llogarie bankare në vitet 2023 dhe 2024; (xii) gjashtë (6) akte që synojnë të provojnë punësimin, jetesën në Itali dhe të ardhurat e krijuara atje nga kunati e bashkëshortja e tij; (xiii) tre (3) shkresa të subjektit në drejtim të Kolegjit (memorie, informacion sqarues dhe dërgim provash), përkatësisht në datat 22.05.2023, 18.05.2022, 01.03.2022 (për marrje provash), si dhe në datën 07.07.2023; (xiv) vërtetim i datës 09.04.2021, nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat; (xv) fotokopje të deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI për vitet 2003-2020; si dhe (xvi) fotokopje e pasaportave të subjektit dhe familjarëve të tij në faqen ku është vendosur viza amerikane e datës 09.03.2023.*

<sup>7</sup> Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: “[a] janë të panevojshme; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit”.

<sup>8</sup> Referuar paragrafit 6, pika (i) e këtij vendimi.

## B. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit

### B.I. *Analiza e shkaqeve procedurale të ankimit*

10. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në procesin e kryer në Komision i është shkelur parimi i proporcionalitetit, objektivitetit, i sigurisë juridike, si dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi vendimi është i paarsyetuar. Nga ana tjetër, shkelja e këtyre të drejtave është parashtruar në mënyrë të përgjithshme, pasi subjekti nuk identifikon rrethana konkrete që kanë përbërë shkelje gjatë procesit të kryer për rivlerësimin e tij në Komision apo pasojat që kanë ardhur prej tyre, duke e vështirësuar ushtrimin e kontrollit nga Kolegji.

10.1. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit analizozi pretendimet e mësipërme nën dritën e parashikimeve të nenit 57<sup>9</sup> të ligjit nr. 84/2016, i cili normon në mënyrë specifike formën dhe përmbajtjen e vendimit të Komisionit, nën dritën e rëndësisë që paraqet arsyetimi i vendimeve gjyqësore, në zbatim të garancive për procesin e rregullt ligjor. Nga kjo analizë rezulton se vendimi i Komisionit është në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit, pasi përmban të gjitha pjesët përbërëse të përcaktuara nga ligji dhe në përmbajtjen e tij shtjellon gjithë elementët e kërkuar: qëndrimin e subjektit, rrethanat e çështjes, provat mbi të cilat mbështetet vendimi, raportin e rezultateve të hetimit dhe dispozitat ligjore mbi të cilat vendimi bazohet. Së fundmi, vendimi objekt ankimi përmban qartësisht masën disiplinore të marrë për subjektin dhe udhëzimin për të drejtën e ankimit e afatin përkatës. Në referencë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit, përpos faktit që mbetet deklarativ e pa asnjë ilustrim për problematikën ekzakte të identifikuar prej tij, është i pabazuar. Për pasojë, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidentoi shkelje të procesit të rregullt ligjor për subjektin e rivlerësimit, edhe në këtë këndvështrim.

### B.II. *Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë*

#### 1. *Apartamenti në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë*

11. Në rubrikën e titulluar “Gjetje të tjera”, Komisioni ka arsyetuar se subjekti nuk ka shpjeguar bindshëm një sërë rrethanash, sikurse dhe as ka përmbysur barrën e provës, për të provuar se një apartament në Tiranë, në pronësi të vjehrrit, nuk përbën pasuri të fshehur të tij [subjektit]. Në këtë vlerësim, Komisioni ka mbërritur duke mbajtur në konsideratë: (i) që subjekti nuk provoi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie nga vjehri e familja e tij; (ii) një deklaratë noteriale të hartuar në dhjetor 2011<sup>10</sup>, nëpërmjet të cilës subjekti ka konfirmuar shlyerjen e gjithë

<sup>9</sup> “[...] 2. Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese. 3. Hyrja e vendimit përmban: a) emërtimin zyrtar të Komisionit; b) trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësën administrativ; c) orën dhe vendin e vendimit të dhënë; ç) emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit, si dhe përfaqësuesve të tij; d) mendimin e subjektit të rivlerësimit dhe/ose të përfaqësuesit të tij. 4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështetet vendimet; 29 c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. 5. Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban: a) alternativën që ka vendosur trupi gjykues; b) nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore; c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij.”

<sup>10</sup> Nr. {\*\*\*}, datë 28.12.2011.



detyrimeve për këtë apartament shoqërisë së ndërtimit/shitësit; (iii) faktin që apartamenti është deklaruar në deklaratimet periodike në vite si adresë banimi e subjektit, pasqyruar edhe në regjistrin të gjendjes civile duke filluar nga viti 2004 e në vijim; si dhe (iv) faktin që nga viti 2017 e deri në kohën e dhënies së vendimit, familja e subjektit banonte në këtë apartament. Po ashtu, Komisioni i ka dhënë peshë faktit që nga analiza financiare e kryer në Komision subjekti rezultoi me balancë negative dhe në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

**11.1.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion duke potencuar se hetimi në Komision është kryer bazuar në raportin e pasaktë e të falsifikuar të ILDKPKI-së dhe bazuar në dokumente të falsifikuara nga shoqëria e ndërtimit [{"\*\*\*"} ShPK]. Subjekti kundërshton edhe konstatimin e Komisionit për mosdeklarim të kontratës së sipërmarrjes dhe pagesës së shumës prej 10.000 eurosh në vitin 2004, duke pretenduar se asnjë nga këto fakte nuk ka ndodhur e, konkretisht, se nuk ka nënshkruar kontratë sipërmarrjeje dhe kryer pagesë. Sipas tij, gjithë mandatarëkëtimet janë depozituar në Komision dhe ato tregojnë që pagesat për apartamentin janë kryer nga i vjehri. Sipas subjektit të rivlerësimit, kontrata e vetme e sipërmarrjes e lidhur për këtë apartament është ajo e datës 25.03.2004 -- depozituar në Komision -- në të cilën porositi është i vjehri.

Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për deklaratën noteriale të dhjetorit 2011, duke e konsideruar atë subjektiv dhe me tendencë përkeqësuese për të. Objekti i interesit pasuror në raport me personin tjetër të lidhur [vjehrin] është vetëm 108.400 lekë, një vlerë e vogël që heq mundësinë e paragjyqimit se nuk mund të disponohet nga një familje.

**11.2.** Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi që konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Edhe në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, tërësia e rrethanave të konstatuara në kontrollin e kësaj pasurie çon në përfundimin se apartamenti në Tiranë, me sipërfaqe 108 m<sup>2</sup>, është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, e cila e kualifikon atë sipas nenit 33, pika 5, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit u vlerësuan të pabazuara dhe jobindëse. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion mbështetet në arsyetimin që shtjellohet në vijim.

**11.3.** Nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, sipas korrespondencës së shoqërisë ndërtuese [{"\*\*\*"} ShPK] dhe ILDKPKI-së, më datë 26.01.2016, rezulton se në vitin 2004 subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë për prenotim apartamenti dhe parapaguar shumën prej 10.000 eurosh për këtë qëllim. Nga të njëjtat akte rezulton edhe që në datën 28.12.2011, subjekti i rivlerësimit ka *hequr dorë nga pronësia* mbi këtë apartament, nëpërmjet një deklaratë noteriale, duke i kaluar të drejtat dhe detyrimet vjehrit të tij, z. G. H.. Ky i fundit, në të njëjtën datë, ka lidhur kontratën e shitblerjes për apartamentin, duke shlyer vlerën prej 2.795.528 lekësh. Shoqëria ndërtuese/shitësi ka përcjellë në ILDKPKI tri akte bashkëlidhur përgjigjes së dërguar ILDKPKI-së në janar 2016, përfshirë dy akte noteriale dhe një formular të furnizimit me energji elektrike: (i) deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.12.2011, nëpërmjet të cilës subjekti heq dorë nga pronësia e apartamentit; (ii) kontratë shitje me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., me shitës [{"\*\*\*"} ShPK] dhe blerës G. H.; (iii) formulari i depozituar në OShEE për ndryshimin e kontraktuesit të energjisë elektrike për këtë apartament, në të cilin pasqyrohet se

abonenti kërkon të bëjë ndryshim emri nga *Tasim Puci në G. H.* dhe apartamenti ka pasur konsum të rregullt energjie duke filluar nga viti 2006<sup>11</sup>.

11.4. Në korrespondencën me Komisionin gjatë hetimit administrativ, shoqëria ndërtuese<sup>12</sup> ka sqaruar se në arkivat e shoqërisë disponon vetëm aktet e mësipërme. Shkresa po ashtu specifikon se aktet e tjera nuk disponohen, pasi detyrimi ligjor<sup>13</sup> për ruajtjen e tyre është 10 vjet. Së fundmi, në shkresë sqarohet se subjekti i rivlerësimit ka parapaguar shumën 10.000 euro, ndërsa vlera prej 2.795.528 lekësh është paguar nga vjehri.

11.5. Nga aktet e sipër referuara rezultojnë disa fakte të cilat trupi gjykues i Kolegjit i mbajti në konsideratë, në konkluzionin se ky apartament përbën pasuri të fshehur të subjektit. Konkretisht, prej tyre rezulton qartë që subjekti ka pasur një marrëdhënie pronësie me apartamentin, pavarësisht se cila prej dy kontratave të sipërmarrjes merret në konsideratë<sup>14</sup>, sikurse arsyetohet gjerësisht në vijim, dhe kryer një sërë veprimesh për këtë qëllim. Pikërisht, për shkak të kësaj marrëdhënieje dhe në cilësinë e porositësit, në datën 28.12.2011, subjektit i është dashur të heqë dorë nga apartamenti formalisht, duke nënshkruar deklaratën noteriale, referuar më sipër në paragrafin 11.3./i, nëpërmjet të cilës i mundësohej vjehrrit blerja e apartamentit. Në atë deklaratë, në mënyrë të shprehur subjekti ka pranuar edhe *prenotimin e apartamentit*, sikurse edhe *shlyerjen e gjithë detyrimeve ndaj shitësit*<sup>15</sup>, duke plotësuar aspekte të sjelljes si pronar me këtë pasuri.

11.6. Rrethanat faktike që rezultojnë nga këto akte janë në harmoni edhe me sa rezulton nga formulari i hartuar nga OShEE-ja lidhur me identitetin e palës kontraktuese në funksion të furnizimit të apartamentit me energji elektrike. Konkretisht, nga formulari i sipër referuar në paragrafin 11.3./iii, nga aktet e gjeneruara nga OShEE-ja rezulton që në marrëdhënie me të tretët, në cilësinë e pronarit për këtë apartament, ka qenë fillimisht subjekti i rivlerësimit, ndërsa vjehri i tij është përfshirë në një fazë të mëvonshme. Kjo gjurmë dokumentare e hershme e marrëdhënies juridike të krijuar, për të mundësuar banimin në këtë apartament apo fakti që nga faturat e energjisë rezulton shpenzim konsistent me jetesën e pandërprerë, vjen në harmoni me deklaratën e subjektit për heqje dorë nga pronësia, sikurse edhe me rrethanat faktike që deduktohen nga aktet e referuara, por të padisponuara në vitin 2016 e pas nga shoqëria e ndërtimit e, konkretisht, kontrata e

---

<sup>11</sup> Kësaj shkresë i janë bashkëngjitur printime nga sistemi elektronik i OShEE-së dhe rezultatet e gjeneruara prej tij, ku rezulton se për këtë kontratë furnizimi ka konsum të rregullt periodik të energjisë elektrike që nga data 24.02.2006. Në të dhënat që kanë rezultuar nga printimet e sistemit vërehet se adresa e këtij matësi është rruga “{\*\*\*}”, Tiranë dhe kabina është emërtuar “{\*\*\*}”.

<sup>12</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 22.07.2020.

<sup>13</sup> Referuar ligjit nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

<sup>14</sup> Subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje bashkë me vjehrrin e tij, në cilësinë e porositëseve, në datën 25.03.2004, me shoqërinë “{\*\*\*}” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit. Me të njëjtën datë rezulton e dorëzuar në Komision edhe një kontratë tjetër sipërmarrjeje me të njëjtat të dhëna, por me ndryshimin se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton si palë nënshkruese e kësaj kontrate.

<sup>15</sup> Subjekti i rivlerësimit shprehet se me kontratën “bashkëlidhur” ka prenotuar një apartament duke i shlyer shoqërisë “të gjitha detyrimet”. Subjekti i rivlerësimit ia kalon apartamentin G. H., duke hequr dorë nga çdo e drejtë në favor të tij dhe njëkohësisht duke autorizuar dhe kërkuar nga shoqëria që kontratën përfundimtare të shitjes ta lidhë me të. Në këtë deklaratë është nënshkrues edhe vjehri i subjektit, i cili ka deklaruar dakordësinë për sa deklaruar nga subjekti.

sipërmarrjes e vitit 2004 apo pagesa fillestare prej 10.000 eurosh si detyrim fillestar nga porositësi në vitin 2004. Me fjalë të tjera, edhe në mungesë të mandatpagesës dhe kontratës së porosisë të vitit 2004, referuar nga shitësi/shoqëria ndërtuese, trupi gjykues i Kolegjit vëren se aktet e tjera në fashikull provojnë në mënyrë indirekte situatën faktike të marrëdhënies së pronësisë së subjektit me këtë apartament.

11.7. *Së fundmi* dhe çfarë është më e rëndësishme, fillimisht dhe pa asnjë rezervë, subjekti pranoi kryerjen e veprimeve juridike për apartamentin, përfshirë deklaratën noteriale të heqjes dorë, si dhe dha shpjegime për shkaqet për të cilat ai ka vepruar. Konkretisht, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, i pyetur në mënyrë specifike nga Komisioni për deklaratën noteriale nëpërmjet të cilës ai hiqte dorën nga pronësia, referuar në paragrafin 11.3.i., subjekti jo vetëm që nuk ka kontestuar nënshkrimin e saj prej tij, por ka shtuar se flitej për një veprim formal kryer për shkak se *prindërit e bashkëshortes [...] ndiheshin të frikësuar për shumën e parave që do jepnin në marrëveshje me pronarin që do ndërtonte pallatin dhe bënë një kontratë provizore thjesht si lidhje marrëveshjeje për arsye të profesionit të subjektit si prokuror, për çështje sigurie*, duke kërkuar që kontratën ta nënshkruante subjekti<sup>16</sup>. Po ashtu, edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 5, datë 24.02.2021, bashkë me shpjegimet për mënyrën sesi vjehri ka përballuar apo kryer konkretisht pagesat për apartamentin, subjekti sërish ka elaboruar se emri i tij është shtuar në akte *për garanci, pasi djali i tyre jetonte në Itali prej shumë vitesh*, duke pranuar sërish, pa asnjë rezervë e përtej çdo kontestimi, dijani të pavesuar për pasqyrimin e emrit të tij në akte të ndryshme në marrëdhënie me shoqërinë ndërtuese.

11.8. Trupi gjykues e çmon me rëndësi të theksojë sa më sipër, në kushtet që në ankim e në parashtrimet e shumta në adresë të Kolegjit, subjekti paraqet një situatë faktike kryekëput *të ndryshme*, nëpërmjet të cilës pretendon *padijeni* për pasqyrimin e emrit të tij në këto akte apo edhe veprime të kundërligjshme nga të tretë. Kjo qasje u vlerësua nga trupi gjykues si një përpjekje e subjektit për *të përmbysur* e kthyer në favor të situatës së tij në proces gjithë sa ka konstatuar Komisioni, bazuar edhe në shpjegimet e zgjeruara të tij gjatë hetimit administrativ. Faktet që rezultojnë nga aktet, pohimet e subjektit dhe analiza e tyre në harmoni, tregojnë se pretendimet në ankim e më pas, përpos atyre gjatë hetimit administrativ me synim atribuimin e pasurisë vjehrit, përveçse jobindëse, janë edhe të pakuptimta nën tërësinë e aspekteve të analizuara. Ky konkluzion gjen zbatim edhe për pretendimet e subjektit që aludojnë për veprime të kundërligjshme nga disa persona fizikë, juridikë, e institucione në dëm të tij, bashkërisht apo veçmas.

11.9. Nga ana tjetër, nëse me të vërtetë veprimet në funksion të porositjes, pagesës dhe përfitimit të apartamentit, përbënin thjesht ndihmesë të subjektit për familjen e bashkëshortes, në kushtet që

---

<sup>16</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti është shprehur tekstualisht: “Në momentin e nënshkrimit të Kontratës, prindërit e bashkëshortes nisur nga fakti se ndiheshin të frikësuar për shumën e parave që do jepnin në marrëveshje me pronarin që do ndërtonte pallatin lidhën një kontratë që ai e quajti provizore thjesht si lidhje marrëveshjeje dhe siç e thashë për arsyen e të qenit tim Prokuror kërkuam që kontratën ta nënshkruaja unë, dhe në momentin që apartamenti kishte përfunduar dhe do përcaktohej pronari siç e kishim biseduar në fillim kam bërë atë deklaratë që e dispononi dhe ju”.

subjekti ka nënshkruar akte dhe është sjellë si pronar i apartamentit, të paktën deri në vitin 2011, do të ishte e pritshme që këto rrethana të pasqyroheshin në deklaratimet periodike të kohës apo gjatë hetimit administrativ në Komision, si pikë fundore. Në kushtet që asnjë nga këto dy versione nuk paraqitet i logjikshëm apo i besueshëm, pretendimet e subjektit të rivlerësimit u vlerësuan të pabesueshme e të pabazuara.

**11.10.** Po ashtu, nëse pronari i apartamentit nuk ishte subjekti, është e pakuptimë përse heqja dorë nga pronësia ndodhi pikërisht në momentin kur do të finalizohet titulli i pronësisë në vitin 2011, ndërkohë që blerësi/t e gëzonin atë faktikisht që në vitin 2006 – sikurse rezulton nga konsumi i energjisë elektrike. Me fjalë të tjera, veprimi i heqjes dorë nga pronësia *formalisht* nga subjekti duket si përpjekje që ndërsa mundëson kalimin përfundimtar të pasurisë nga shitësi, në të njëjtën kohë mënjanon evidentimin e emrit të tij në aktet e pronësisë në institucionet përkatëse si ASHK etj.

**11.11.** Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi, përveçse jo bindëse, edhe pa peshë<sup>17</sup>, pretendimet e subjektit për rrethana faktike *alternative*, sikurse është mungesa e dijenisë, qoftë në ankim, në parashtime apo edhe në aktet e përcjella vazhdimisht në adresë të Kolegjit, në vijim të kallëzimit penal të depozituar prej tij<sup>18</sup>. Subjekti ishte në dijeni të situatës ligjore të konstatuar nga Komisioni që me rezultatet e hetimit, me të cilat i është vënë në dukje që veprimet juridike të kryera prej tij në lidhje me këtë pasuri nuk kishin gjetur pasqyrim në deklaratat periodike vjetore ndër vite. Edhe fakti që asnjë nga këto veprime nuk ka gjetur gjurmë në deklaratat periodike vjetore të subjektit ndër vite u vlerësua si një aspekt i qasjes së subjektit në vazhdimësi për të evituar kontrollin e interesave të tij pasurore.

**11.12.** Përpos sa më sipër, sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë edhe *pamundësinë* financiare të vjehrrit të subjektit për të krijuar këtë pasuri me të ardhurat e dokumentuara, përfshirë edhe të ardhurat e *kunatit* të subjektit nga punësimi në Itali. Analiza e kryer në këtë kontekst, në Komision e në Kolegj, ishte një ndër aspektet e kontrollit për pasuri të fshehur të subjektit. Si e tillë, sikurse shtjelluar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, kontrolli nuk i nënshtrohet kufijve që krijon marrëdhënia e personit tjetër të lidhur, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, prapësimet e subjektit për të mospërfshirë vjehrrin si person tjetër të lidhur janë të pabazuara. Komisioni nuk rezulton ta ketë analizuar mundësinë e krijimit të apartamentit për shkak të konstatimit të kësaj cilësie, por në funksion të hetimit për të përjashtuar

---

<sup>17</sup> Referuar më sipër në paragrafin 9.1., si dhe poshtëshënimet 6, 7 dhe 8.

<sup>18</sup> Ndër aktet që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj pas ankimit, më datë 16.12.2021, ishte korrespondencë për depozitimin e një kallëzimi penal, lidhur me deklaratën noteriale të datës 28.12.2011. Subjekti pretendon po aty se deklaratën nuk e ka hartuar noterja, por juristi i shoqërisë ndërtuese. Më pas i vjehrrit, sipas tij, është thirrur te shoqëria e ndërtimit nga një i njohur, dhe se gabimisht i është thënë që kontrata e sipërmarrjes është bërë në emër të dhëndrit (subjektit të rivlerësimit) dhe duhet të nënshkruhet deklarata noteriale, të cilën subjekti shpjegon e ka firmosur “pa i vënë rëndësi”.

mundësinë e fshehjes së pasurisë së subjektit<sup>19</sup>. Në të njëjtën linjë, e konkretisht, atë të hetimit për fshehje pasurie, mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë ishte vetëm një ndër elementët e analizës tërësore të kryer nga Kolegji, mbi bazën e të cilës u konkludua për pasuri të fshehur të subjektit.

**11.13.** Në vijim të arsyetimit më sipër, për burimet e deklaruara për krijimin e kësaj pasurie, rezulton se subjekti ka pretenduar se si burim krijimi i apartamentit kanë shërbyer të ardhurat nga *puna* e vjehrrit të tij si elektrikist, të ardhurat nga *puna* e vjehrrës [në PTT] dhe të ardhurat e djalit të tyre/vëllait të bashkëshortes, nga *puna* në Itali. Nga ana tjetër, duke qenë se vetëm subjekti i rivlerësimit ishte i punësuar në familjen e tij, paga e tij nuk mjaftonte për blerjen e këtij apartamenti. Në këto kushte, pasi ka kryer analizën e burimeve të deklaruara nga subjekti në funksion të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka provuar të ardhurat e ligjshme. Edhe në analizën e kryer në Kolegj për këtë aspekt të vendimit, u konfirmua konkluzioni i Komisionit, pavarësisht e duke abstraguuar nga mospërputhjet në çmimin e apartamentit që rezultoi nga aktet apo mes kalendareve të pagesave, sipas shpjegimeve të shoqërisë së ndërtimit dhe mandatpagesave të sjella nga subjekti<sup>20</sup>, në pikën fundore, gjithsesi, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me pamundësi financiare për krijimin e pasurisë<sup>21</sup>.

**11.14.** Në këtë përfundim, trupi gjykues vëren *së pari* se dokumentacioni i administruar për të provuar të ardhurat e vjehrrit nga punësimi nuk pasqyron vlera përkatësisht për vitet deri në 2006<sup>22</sup>. *Së dyti*, për të ardhurat e vjehrrës, subjekti ka dorëzuar vetëm disa mandate bankare për të provuar transaksione bankare në formë çelje depozitash prej saj në vitin 2002 dhe 2003, në shumën të cilat në total janë afërsisht 2.8 milionë lekë të tërhequra në vitin 2004. Ndonëse koha e tërheqjes (nëntor 2004) përkon me kohën e pagesave të apartamentit dhe vlera e përftuar do të ishte e mjaftueshme

---

<sup>19</sup> *Ndër të tjerë, reflektuar në paragrafin 110 të vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket çështjes së subjektit të rivlerësimit D. Rreshka, JR nr. 15/2019: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-SR-Dritan-Rreshka-i-anonimizuar-per-publikim.pdf>.*

<sup>20</sup> *Sipas kontratës jonoteriale të sipërmarrjes, datë 25 mars 2004, përcjellë nga subjekti me prapësimet e rezultateve të hetimit, çmimi i apartamentit është përcaktuar 54.200 euro. Kësti i parë, prej 3.300 eurosh do të paguhej në datën 25.03.2004, me lidhjen e kontratës; kësti i dytë, me përfundimin e karabinasë në datën 25.05.2004; kësti i tretë në nëntor të vitit 2005 në shumën 35.000 euro dhe kësti i fundit, në shumën 14.200 euro, me marrjen në dorëzim të apartamentit në datën 28.11.2005. Nga totali i kësteve plotësohet çmimi i përcaktuar në këtë kontratë prej 54.200 eurosh. Nga shumën e kësteve në mandatarkëtime (përmbledhur edhe në poshtëshënimin nr. 29), rezultoi se tejkalohej çmimi i përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, në total rreth 50.025 euro, pa përfshirë mandatarkëtimin në emër të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka nënshkruar vetëm mandatin e datës 11.04.2006, në të cilin është arkëtuar shumën prej 108.400 lekësh, meqenëse vjehrrin, i cili në atë kohë jetonte në qytetin e Përmetit, kishte një problem serioz.*

<sup>21</sup> *Sipas mandatarkëtimeve të depozituara prej tij, subjekti rezultoi me mungesë burimesh në vitin 2004 në vlerën (-) 3.714.501 lekë dhe për vitin 2005 në vlerën (-) 312.061 lekë. Nëse mbahet në konsideratë sa ka shpjeguar shoqëria e ndërtimit, subjekti rezultoi me mungesë burimesh prej (-) 61.046 lekësh në vitin 2004 dhe (-) 2.588.076 lekësh në vitin 2011.*

<sup>22</sup> *Në vërtetimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore [nr. {\*\*\*} prot.], datë 27.01.2020, administruar në dosje, rezultoi se vjehrrin (G. H.) është trajtuar me pagesë papunësie për një vit, 2002 deri në vitin 2003 dhe nga viti 2006 ka punuar si elektrikist në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Në këtë dokumentacion nuk specifikohen vlerat e të ardhurave të gjeneruara prej tij për vitet 2002-2006.*

për të mbuluar kështet e vitit 2004<sup>23</sup>, edhe në vlerësimin e kryer nga Kolegji, sikurse në Komision, nga aktet është e pamundur të provohet se këto shuma janë krijuar me burime financiare që i përkasin familjes së origjinës së bashkëshortes apo se janë përdorur prej tyre e për qëllim të pagesës së apartamentit objekt analize.

11.15. Po ashtu, dokumentacioni i administruar për të ardhurat e *kunatit* të subjektit<sup>24</sup> konfirmon punësim me periudha të *shkëputura*, nga të cilat është e pamundur të vlerësohet çfarë ka ndodhur në periudhat e ndërmjetme në drejtim të punësimit apo gjenerimit të të ardhurave apo cili ka qenë vendqëndrimi për këto periudha, nëse në Itali apo Shqipëri. Me fjalë të tjera, nga aktet e sjella nga subjekti është e pamundur të kryhet një analizë e mirëfilltë apo e saktë, qoftë edhe pjesërisht, për të ardhurat apo për shpenzimet e jetesës. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se familja e kunatit përbëhej nga tre persona (bashkëshortët dhe një fëmijë). Në kushtet që subjekti nuk ka saktësuar periudhën e qëndrimit të kunatit në Itali, shpenzimet e jetesës janë përlogaritur për të njëjtin segment kohor sa edhe periudha e punësimit. Pavarësisht nga kjo qasje tejet garantiste, edhe nga kontrolli i ushtruar në Kolegji ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni për kunatin e subjektit deri në vitin 2005, rezultoi *pamundësi* për të përballuar *ndonjë* nga kështet e referuara, qoftë në kontratën e sipërmarrjes apo sipas kalendarit të mandatpagesave. Nga kjo analizë, rezulton që kunati i subjektit mund të kursente një shumë prej *656 eurosh*<sup>25</sup>, duke zbritur *vetëm* shpenzimet e jetesës sipas Eurostat<sup>26</sup> dhe për periudhat e punësimit.

11.16. Në kushtet që të ardhurat e dokumentuara të prindërve të bashkëshortes janë modeste, sikurse analizohet edhe në vijim, është e pamundur të kenë qenë krijuar nga kunati i subjektit, ndërsa nga ana tjetër subjekti nuk ka provuar gjurmë të ekzistencës apo lëvizjeve të tyre, në drejtim të shoqërisë së ndërtimit dhe mbi të gjitha nën dritën e gjithë aspekteve të tjera që e bëjnë të pabesueshëm investimin e familjes së vjehrrit të subjektit në këtë pasuri, ndërkohë që ai dhe bashkëshortja jetonin në mënyrë të vazhdueshme në Përmet, ndërsa i biri jashtë Shqipërisë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson pa peshë përcaktuese edhe përkimin në kohë të tërheqjes së depozitave me pagesat e kryera për të arritur në përfundimin që pasuria në fakt i përket vjehrrit të subjektit.

11.17. Në balancën tërësore të gjithë aspekteve të marra në analizë, fakti i vetëm i tërheqjes së fondeve në kohë të afërt me pagesat e kësteve u vlerësua nga trupi gjykues *i pamjaftueshëm* për të përmbysur konkluzionin se apartamenti përbën pasuri të fshehur të subjektit, përkundër gjithë elementëve të tjerë si: mungesa e provave për mënyrën e krijimit të fondeve të tërhequra nga

---

<sup>23</sup> Sipas mandatarkëtimeve, 38.225 euro ose 4.878.456 lekë, ndërsa pagesa e kësteve referohet në vlerën 4.142.052 lekë.

<sup>24</sup> Dokumentacioni i sjellë me ankimin u vlerësua në mospërbushje të kushteve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, sikurse edhe të pamjaftueshme për të ndryshuar zgjidhjen e çështjes, sikurse arsyetuar më sipër në paragrafin 9.1.

<sup>25</sup> Të ardhurat deri në këtë vit kanë qenë në shumën 39.278 euro. Shpenzimet e jetesës për familjen e kunatit të subjekti të rivlerësimit, sipas Eurostat, deri në vitin 2005 kanë qenë në shumën 39.319,25 euro. Nga këto të dhëna rezulton se të ndjerit kunatit të subjekti të rivlerësimit i tepronin nga diferenca të ardhura shpenzime vetëm 656 euro, të cilat nuk mjaftojnë për kryerjen e pagesave të asnjë prej kësteve të apartamentit objekt kontrolli.

<sup>26</sup> <https://ec.europa.eu/eurostat/data/database>

vjehrra në vitin 2004 dhe burimin e tyre, sjelljen e subjektit me apartamentin dhe aktet shkresore të hartuara, mungesa e logjikës ekonomike të krijimit të kësaj pasurie nga tre individë me *asnjë lidhje* me Tiranën apo që nuk provohet të kenë vjelë ndonjë fryt nga investimi në këtë pasuri, përpos mungesës së burimeve për krijimin e saj, mungesës së transparencës së subjektit ndër vite për veprimet e kryera, si dhe mospërputhjet e qenësishme mes shpjegimeve të tij gjatë procesit të rivlerësimit për to [veprimet] e ndryshimet tërësore të pretendimeve të tij për rrethanat faktike. Përkundrazi, nga analiza e mësipërme dhe pohimet e subjektit, ka rezultuar që prindërit e bashkëshortes dhe kunati [i ndjerë] nuk kanë jetuar në Tiranë, ndërsa përfitime prej saj duket se kanë krijuar kryesisht vetëm subjekti dhe personat e lidhur me të, të cilët kanë jetuar në Tiranë, duke nisur nga viti 2017 në mënyrë të vazhdueshme<sup>27</sup>, por edhe në periudha të mëparshme<sup>28</sup>. Në këtë linjë, si provë e marrëdhënies së vazhdueshme të subjektit me apartamentin u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit edhe mandatpagesa e fundit e apartamentit e kryer nga subjekti në datën 11.04.2006. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, për arsyet për të cilat i është dashur që ai të kryejë pagesën, u vlerësuan jobindëse, analizuar në tërësi me gjithë aspektet e tjera të kësaj analize.

**11.18.** Në vijim të arsytimit të mësipërm, aktet e sjella nga subjekti për të treguar një mënyrë të ndryshme pagese apo dinamikë të kësteve të shlyera për apartamentin<sup>29</sup>, kryesisht nga i vjehri, ndër të tjera, edhe për të kontestuar pagesën e kryer prej tij [subjektit] në vitin 2004 për shumën prej 10.000 eurosh, u vlerësuan pa peshë nën dritën e rrethanave të tjera të konstatuara e shtjelluara më sipër e në vijim. Në kushtet që analiza tërësore e harmonike e gjithë rrethanave tregon mungesë burimesh, qoftë nga prindërit e bashkëshortes së subjektit apo nga kunati, dhe mbi të gjitha mungesë interesi financiar apo faktik për këtë investim, për shkak të rrethanave jetësore të vjehrit apo kunatit, përkundër marrëdhënies së vazhdueshme që rezulton të ketë pasur vetë subjekti e personat e lidhur me të ndër vite, sikurse rezulton nga dokumentacioni i sipëranalizuar, si dhe duke vënë re që pretendimet e subjektit karakterizohen nga kontradikta të theksuara në vetvete, në faza të ndryshme të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se moria e akteve të dërguara në adresë të Kolegjit pas ankimit, edhe nëse do të përmbushej kriteri i akteve të reja që ligji lejon, nuk do të përmbyste as balancën negative financiare që ka rezultuar për krijimin e kësaj pasurie nga vjehri.

**11.19.** Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues mbajti në konsideratë disa aspekte të rezultuara nga aktet në fashikull dhe nga analiza e shpjegimeve të tij në lexim harmonik me aktet, për të cilat subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, si vijon: (i) deklarata noteriale [me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.], në të cilën subjekti ka deklaruar heqjen dorë nga të gjitha të drejtat

---

<sup>27</sup> Subjekti ka pohuar (referuar përdorimit të automjetit të arsyetuar në vijim) dhe në përgjigje të pyetësorëve se familja e tij ka jetuar në Tiranë duke filluar nga viti 2017. Shih edhe përgjigjet e pyetësorit standard për shkollimin privat të fëmijëve të tij duke filluar nga kjo periudhë kohore.

<sup>28</sup> Sipas përgjigjeve të subjektit në pyetësorin standard.

<sup>29</sup> Shih edhe poshtëshënimin nr. 20. Konkretisht, me rezultatet e hetimit, subjekti ka sjellë shtatë mandatarkëtime të kryera mes datës 25.03.2004 dhe 11.04.2006, gjashtë prej të cilave paraqesin arkëtime të kryera nga vjehri në vlera që variojnë nga 2.300 euro në 12.000 euro, ndërsa i shtati, i datës 11.04.2006, në vlerën 108.400 lekë, është kryer nga vetë subjekti me përshkrimin "hipotekë 108.4x1000". Në total, pagesat që rezultojnë nga këto arkëtime janë në vlerën prej 46.725 eurosh dhe 108.400 lekësh.

reale nga apartamenti, e hartuar në datën 28.12.2011, ditën që është nënshkruar edhe kontrata e shitblerjes së këtij apartamenti nga vjehri i subjektit; (ii) aktet e dërguara nga OSHEE, nga ku rezulton se fillimisht kontrata e furnizimit me energji elektrike është hartuar në emër të subjektit të rivlerësimit, ndryshuar më pas për të reflektuar emrin e vjehrit të tij [z. H.]; (iii) shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në hetimin administrativ, kur ka pranuar që kontrata e sipërmarrjes *provizore* pasqyron atë [subjektin] si blerës dhe pagesën e kështit të parë prej 10.000 eurosh; (iv) një ndër mandatet e arkëtimit të paguar prej tij [në datën 11.04.2006] për pjesën tjetër të pagesës, që dëshmon marrëdhënie të vazhdueshme të subjektit dhe përfshirje edhe pas pagesës së kështit të parë në shlyerjen e detyrimeve; (v) pamjaftueshmërinë financiare të prindërve të bashkëshortes së subjektit për krijimin e shumës së likuiduar për blerjen e apartamentit dhe atribimin e mbulimit të tyre kumatit, vetëm në një pyetësor të mëvonshëm, pasi është pyetur në mënyrë specifike nga Komisioni; (vi) pamjaftueshmërinë financiare të kumatit për të krijuar me të ardhura të ligjshme e të konfirmuara nëpërmjet dokumentacionit, vlerën e paguar për blerjen e pasurisë; (vii) faktin që prindërit e bashkëshortes kanë qenë të punësuar në Përmet me kohë të plotë e në mënyrë të vazhdueshme, deri në daljen në pension në vitin 2014; si dhe (viii) faktin që subjekti i rivlerësimit nuk kishte burime financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri.

11.20. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit i gjeti kontradiktore shpjegimet e subjektit në drejtim të arsyeve të pretenduara për paraqitjen e tij si porosites apo për arsyet për të cilat veprimet janë kryer prej tij e, për pasojë, jobindëse. Në të njëjtën linjë, trupi gjykues i vlerësoi edhe përpjekjet e subjektit për t'ia ngarkuar përgjegjësinë të tretëve, nëpërmjet adresimit të organeve të prokurorisë për të kontestuar aktet e hartuara, si një përpjekje e tij për t'iu shmangur konkluzionit të logjikshëm që rezulton nga aktet, nga shpjegimet e vetë subjektit dhe faktet që rezultojnë prej tyre. Të gjitha këto rrethana e kualifikojnë subjektin e rivlerësimit në kushtet e fshehjes së pasurisë, parashikuar nga neni D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

## 2. Automjeti i blerë në vitin 2012

12. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një *automjet*<sup>30</sup> në vlerën 500.000 lekë të *paregjistruar* në DPSHTRr, me burim *kursimet e pagës*. Komisioni ka konkluduar se subjekti rezultoi në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në shumën (-) 355.878 lekë, në vitin 2012. Për sa i përket mosregjistrimit, përveçse në shkelje të ligjit, është një sjellje e papranueshme, sidomos për një prokuror. Duke vënë re që kjo sjellje e subjektit është kryer në mënyrë të përsëritur për një periudhë të gjatë, edhe pasi ndaj tij janë vendosur gjopa nga Policia e Shtetit, Komisioni ka referuar dispozitat ligjore që gjejnë zbatim për gjithë automjetet në qarkullim<sup>31</sup> që rregullojnë regjistrimin, pajisjen me lejeqarkullimi, detyrimet vjetore ndaj buxhetit të shtetit, kontrollin teknik, të cilat nuk janë respektuar në rrethanat konkrete. Komisioni

<sup>30</sup> Tip “DaimlerChrysler”, me targë {\*\*\*}.

<sup>31</sup> Nenet 79, 24 dhe 191 të ligjit nr. 8378/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.



rezulton të mos i ketë pasqyruar këto konkluzione në vlerësimin përfundimtar për pasurinë, duke u fokusuar vetëm në pasurinë apartament, që gjen pasqyrim më tej në këtë vendim.

**12.1.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk e ka përdorur automjetin meqenëse banonte afër vendit të punës. Detyrimin për regjistrim nuk e ka mohuar dhe nuk rezulton asnjë tentativë e tij për ta shmangur, minimizuar apo ndryshuar gjendjen faktike, duke shfrytëzuar detyrën e tij në përputhje me etikën dhe sjelljen e prokurorëve. Mosregjistrimi i automjetit është shkelje e Kodit Rrugor e ligji parashikon sanksione në formën e kamatëvonesave, ndërsa konkluzionet e Komisionit shkelin parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit në dhënien e një mase të mundshme ndëshkimore. Për sa i përket balancës negative prej (-) 355.878 lekësh për krijimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit pretendon se ky automjet është *e vetmja pasuri e tij në të gjithë vitet e punës*. Mbatja e këtij mjeti të paregjistruar, mungesa e lejes së qarkullimit, kontrollit teknik, mungesa e lejes së vlefshme të drejtimit, tregojnë se bën shpenzime modeste. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka pretenduar se një pjesë të pagesës për blerjen e mjetit e ka siguruar nga kursimet e një pjesë borxh. Subjekti shprehet se nuk pajtohet me tabelën e analizës financiare, por nuk rezulton ta ketë kundërshtuar në detaje atë.

**12.2.** Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2012. Për këtë arsye, pretendimet e subjektit për aspektin financiar të kësaj pasurie u gjetën të bazuara. Nga ana tjetër, Komisioni nuk rezulton të ketë mbajtur një qëndrim në vlerësimin etiko-profesional apo të ketë mbajtur në konsideratë mosregjistrimin e automjetit në funksion të masës disiplinore të marrë. Përkundrazi, Komisioni duket të jetë mjaftuar vetëm me konstatimin në paragrafin 1.6.ii., si pjesë e vlerësimit pasuror pa specifikuar peshën respektive të tij në vlerësimin e subjektit. Për rrjedhojë, ndonëse trupi gjykues i Kolegjit konfirmon problematikën e konstatuar nga Komisioni, vlerësoi të mos e bazojë vendimin e tij në këtë aspekt. Arsyetimi i trupit gjykues për aspektin e krijimit të kësaj pasurie me burime të ligjshme shtjellohet në vijim.

**12.3.** Nga aktet në fashikull rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si referuar më sipër, përfshirë vlerën e blerjes së automjetit, burimet e krijimit, si dhe të dhënat për markën dhe targën e automjetit. Në Deklaratën e Interesave Private Periodike për vitin 2012 (në vijim “DIPP”), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë konsistente me deklaratën *vetting*. Këto të dhëna konfirmohen edhe nga aktet dokumentare në fashikull<sup>32</sup>. Nga ana tjetër, nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar edhe që subjekti nuk e ka regjistruar këtë automjet në emrin e tij apo të personave të lidhur, sikurse as edhe automjetin e mëparshëm<sup>33</sup>. Ky fakt është konfirmuar

---

<sup>32</sup> Në dosjen e ILDKPKI-së gjendet e administruar kontrata noteriale e shitblerjes, datë 27.06.2012, nëpërmjet të cilës subjekti ka fituar pronësinë e automjetit [marka “DaimlerChrysler”], kundrejt çmimit 500.000 lekë.

<sup>33</sup> DPSHTRr-ja ka informuar Komisionin (me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.1.2020) se nuk ka automjet të regjistruar në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur. Nga dosja e plotë e automjetit depozituar nga DPSHTRr-ja në Komision, ajo rezultonte e regjistruar deri në kohën e shkresës në pronësi të shitësit. Nga verifikimi në sistemin e Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim “AMF”), për automjetin nuk ka rezultuar e paguar asnjë policë sigurimi.

edhe nga aktet e përcjella Komisionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit<sup>34</sup>. Nga këto akte rezultoi edhe që subjekti e ka përdorur automjetin, në kushtet që është gjobitur *personalisht* dhe ndaj tij është marrë vendim kundërvajtjeje administrative në vitin 2016, ndërsa mjete është gjobitur edhe në vitin 2020. Gjobat kanë qenë të papaguara deri në datën e shkresës, gjatë kohës kur Komisioni kryente hetimin administrativ, në shkurt 2021.

12.4. Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit se nuk e ka përdorur mjete nuk pasqyrojnë të vërtetën. Gjithë faktet që rezultojnë nga aktet e sipër referuara paraqesin një panoramë faktike të ndryshme nga ajo e prezantuar nga subjekti. Duke i vlerësuar sa më sipër, nga aktet deduktohet një qasje e qartë e subjektit për të evituar edhe shlyerjen e detyrimeve bazike financiare ndaj buxhetit të shtetit, që ka zgjatur për të paktën nëntë (9) vjet – nga viti 2012 deri në shkurt 2021.

12.5. Për sa më sipër, edhe dokumentacioni i sjellë, për të provuar se automjeti ka qëndruar i parkuar në oborrin e prokurorisë ku ushtronte detyrën, u vlerësua pa peshë nën dritën e detyrimeve ligjore, përpos që i tillë që nuk pasqyron të vërtetën që rezulton nga aktet, përfshirë gjobat e administruara ndër vite. Mosregjistrimi në DPSHTRr si një detyrim i Kodit Rrugor çon dyshimin në një nivel të arsyeshëm se subjekti i rivlerësimit ka pasur si qëllim shmangien e detyrimeve periodike vjetore të automjetit, siç janë kontrolli teknik, taksa vjetore dhe sigurimi i mjetit. Si rrjedhojë e këtij arsytimi, trupi gjykues i Kolegjit thekson rëndësinë që paraqet sjellja e një prokurori duke reflektuar standardet më të larta të zbatimit të ligjit, e që të mos lejojë që interesat personale, financiare dhe marrëdhëniet familjare të ndikojnë në mënyrë jo të duhur në sjelljen e tij, ndër të tjera, edhe në konsideratë të integritetit profesional. Nga ana tjetër, pa përsëritur sa është përmbledhur më sipër për peshën jo përcaktuese të këtij aspekti në rrethanat konkrete, trupi gjykues i Kolegjit e fokusoi analizën në shqyrtimin e këtij shkaku ankimi kryesisht në drejtim të burimeve të ligjshme për krijimin e automjetit në vitin 2012.

12.6. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2012, të fragmentuar deri në momentin e blerjes së automjetit më datë 27.06.2012, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 355.878 lekë. Komisioni ka arsyetuar se shpjegimet e subjektit për huan e marrë për blerjen e kësaj pasurie, përpos kursimeve nga pagat, nuk mund të pranohen, referuar deklarimeve të në deklaratat periodike ndër vite, në të cilat

---

<sup>34</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka informuar Komisionin [me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.02.2021] se subjekti i rivlerësimit disponon leje drejtimi, nuk ka mjet në pronësi ndërsa automjeti objekt analize, në pronësi të shitësit [z. N. D.], me banim në Elbasan ka qenë subjekt i dy gjobave të pa likuiduara. Konkretisht, automjeti është gjobitur: (i) në datën 15.06.2020, në shumën 1.000 lekë dhe kundërvajtësi nuk ka qenë prezent, për shkelje të parashikuara nga neni 156/6 i Kodit Rrugor; dhe (ii) në datën 04.08.2016, gjobë me status “e papaguar”, me kundërvajtës Tasim Puci, për shkelje të parashikuara nga nenet 79/10, 124/1/11 dhe 191/1/2 të Kodit Rrugor. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni gjendet një vendim për një kundërvajtje administrative, datë 12.08.2016, të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për z. Tasim Puci, ku është konstatuar se ky individ ka drejtuar automjetin me targa {\*\*\*}, në pronësi të z. N. D., pa kryer kontrollin teknik vjetor me më shumë se një muaj, pa kryer sigurimin e detyrueshëm të automjetit, si dhe me leje drejtimi të cilës i ka kaluar afati i vlefshmërisë. Masa e dënimit, ndaj subjektit për këtë kundërvajtje në shumën prej 40.000 lekësh, rezulton se nuk është likuiduar.

mungojnë kursimet *cash* apo marrja e ndonjë huaje, sikurse ka pretenduar për blerjen e automjetit. Për sa më sipër, Komisioni vlerësoi se subjekti gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit.

12.7. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se pamundësia e konkluduar për krijimin e kësaj pasurie bazohet në një përlllogaritje të gabuar të burimeve të ligjshme. Konkretisht, për vitin 2012, Komisioni nuk ka përlllogaritur të ardhurat për 6 muaj, por për afërsisht tre muaj (2.9 muaj), ndonëse automjeti është blerë më 27.06.2012. Gjithashtu, rezulton se Komisioni ka vendosur vlerë të gabuar të gjendjes së llogarisë bankare, që ka sjellë si pasojë thellimin e diferencës negative të vitit 2012. Nga korigjimi i këtyre vlerave në Kolegji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të blejë automjetin [DaimlerChrysler], pasi deri në datën e blerjes rezulton me balancë pozitive në shumën 72.684 lekë.

12.8. Në përfundim, në kushtet që Komisioni e ka bazuar masën disiplinore në vijim të analizës së kësaj pasurie vetëm në aspektin financiar, i cili u korigjua në Kolegji, gjetjet e tjera që lidhen me sjelljen e subjektit në lidhje me automjetin nuk mund të passjellin pasojë në rrethanat konkrete procedurale. Konkretisht, duke qenë se Komisioni e ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit pozitivisht për vlerësimin e aftësive profesionale<sup>35</sup> dhe në konkluzionin përfundimtar e ka bazuar masën disiplinore vetëm në kriterin e vlerësimit pasuror, analiza e kryer në drejtim të evitimit të shlyerjes së detyrimeve ligjore të subjektit, për të regjistruar automjetin apo mospagimi i detyrimeve administrative, nuk mund të jetë bazë për shkarkimin e tij nga detyra.

### 3. *Transferrat bankare*

13. Komisioni ka hetuar për disa transaksione bankare të kryera nga vjehri i subjektit dhe bashkëshortja, ndër vite. Konkretisht, vjehri i subjektit i ka dërguar subjektin një sasi likuiditetesh në vitet 2011-2012, bashkëshortja e subjektit të atit të saj nëpërmjet depozitimeve *cash* në vitet 2012-2019 dhe së fundmi, vjehri, bashkëshortes së subjektit në vitet 2014-2019. Gjithashtu, në favor të bashkëshortes së subjektit ka depozituar edhe një individ në vitet 2014-2016 disa shuma relativisht të vogla. Përfundimisht, Komisioni ka konstatuar se transaksionet bankare janë të paqarta, ndërkohë që subjekti nuk ka shpjeguar dhe dokumentuar burimet e ligjshme të të ardhurave të vjehrit, i cili për këto transaksione është cilësuar person tjetër i lidhur. Përpos sa më sipër, Komisioni nuk rezulton të ketë konkluduar duke u dhënë peshë këtyre konstatimeve në vlerësimin përfundimtar.

13.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se transaksionet janë kryer si pasojë e marrëdhënies së vjehrit me vajzën e tij për mobilimin e apartamentit, në formën e ndihmës për të përballuar shpenzimet e përditshme. Për burimet që kanë shërbyer për këtë qëllim, subjekti rithekson të

---

<sup>35</sup> Referuar konkluzionit të Komisionit në vendim nën titullin: "Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale" në faqen 29, sikurse edhe në faqen 8, paragrafi 1.6.ii.

ardhurat e vjehrrit nga puna si elektrikist, depozitat bankare, si dhe dy kredi të marra prej tij për të plotësuar nevojat familjare. Po ashtu, sikurse edhe për apartamentin, subjekti i rivlerësimit parashtron se burimi i krijimit të tyre janë të ardhurat e sjella nga kunati i tij ndër vite nga emigracioni, por edhe kursime nga të ardhurat e krijuara për shkak të dy vdekjeve të njëpasnjëshme në familjen e bashkëshortes (vëllai dhe nëna) brenda dy muajve në vitin 2009.

13.2. Nga analiza e akteve në fashikull, trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi se vjehri ka depozituar në favor të subjektit shumat 1.365.237 lekë dhe 2.779 USD, në vitet 2011-2012, ndërsa në favor të bashkëshortes së subjektit shumën 927.110 lekë, në vitet 2014-2019. Nga ana tjetër, bashkëshortja e subjektit ka depozituar në favor të të atit në vitet 2012-2019 shumën prej 731.216 lekësh. Këto veprime nuk kanë gjetur pasqyrim në deklaratat periodike vjetore apo në deklaratën *vetting*. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti nuk ka dhënë sqarime të plota e bindëse gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pamundësuar verifikimin e dinamikës financiare që qëndron në bazën e veprimeve në fjalë, qoftë për *dhurimet* e vjehrrit nën dritën e detyrimeve që rrjedhin nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, qoftë si subjekt deklarues, ndër vite, sipas ligjit nr. 9049/2003<sup>36</sup>. Këto aspekte marrin rëndësi të veçantë në kushtet që sikurse është arsyetuar gjerësisht më sipër, prindërit e vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kanë provuar vetëm të ardhura modeste, ndërsa vjehri vetë ka dalë në pension pleqërie në vitin 2014, periudhë që përkon me fillimin e depozitave në favor të së bijës/personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

13.3. Pa vënë në dyshim marrëdhënien e ngushtë familjare, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se transfertat e kryera nga vjehri i subjektit në drejtim të subjektit dhe personit të lidhur përbëjnë një aspekt domethënës, që përpos mungesës së burimeve, nën dritën e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet edhe si një pasqyrim i krijimit të marrëdhënieve financiare të pashpjeguara nga subjekti, në linjë me sa është konstatuar edhe për veprimet juridike të krijuara për apartamentin e analizuar më sipër, për sjellje të subjektit në mungesë transparence. Në analizën financiare të kryer në funksion të shkaqeve të ankimit, në kushtet që subjekti nuk provoi të ardhurat e vjehrrit me burime të ligjshme, likuiditetet e depozituara prej tij nuk u përfshinë në mesin e të ardhurave në analizën financiare që i përket subjektit të rivlerësimit.

14. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Tasim Puci gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 366, datë 15.04.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

---

<sup>36</sup> Neni 4, shkronja "d".

## **PËR KËTO ARSYE,**

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 366, datë 15.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Tasim Puci.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 18.04.2024.

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*